



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-047

Prishtinë, më 7 nëntor 2018, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 7 NËNTOR 2018

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Armend Zemaj, Elmi Reçica, Glauk Konjufca, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Valmir Klaiqi dhe Gazmend Krasniqi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

**Nga OSBE-ja:** Sanije Berisha,

**Nga EURS-ja:** Blerta Bejtullahu dhe

**Nga NDI-ja:** Shefki Kastrati.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe dy (2) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Kërkesa e 42 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Kosovës për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për debat parlamentar lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës,
2. Shqyrtimi i kërkesave për lejimin e udhëtimeve jashtë vendit.

### **1. Kërkesa e 42 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Kosovës për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për debat parlamentar lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës**

Kryetari i njoftoi të pranishmit se 42 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 69.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kanë parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancë të jashtëzakonshme për debat parlamentar lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës, më 16 nëntor 2018.

Lidhur me kërkesën e 42 deputetëve të Kuvendit të Kosovës për seancë të jashtëzakonshme diskutuan: Elmi Reçica, në emër të GP të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të propozuesit të kërkesës së seancës së jashtëzakonshme, si dhe në emër të GP të LDK-së; Bilall Sherifi, kryetar i GP të Nismës Socialdemokrate; Dardan Sejdiu, kryetar i GP të PSD-së, dhe Ahmet Isufi, kryetar i GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia pas diskutimeve të lartshënuara vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet të premtën, më 16 nëntor 2018, në orën 10:00, me këtë:

### **Rend dite**

*1. Debat parlamentar lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës.*

## **2. Shqyrtimi i kërkesave për lejimin e udhëtimeve jashtë vendit**

*2.1 Kërkesa e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për lejimin e udhëtimit zyrtar në Londër (Angli)*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

### **V E N D I M**

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Nait Hasani, Albert Kinolli dhe Imet Rrahmani, u lejohet udhëtimi zyrtar në Londër (Angli), prej 19 - 23 nëntor 2018.

Por, në rast se gjatë ditëve të lartshënuara Kuvendi do të mbajë seancë plenare, udhëtimi do të anulohet.

*2.2 Kërkesa e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel (Belgjikë)*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

### **V E N D I M**

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Fidan Rekalju, u lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel (Belgjikë), prej 18 - 21 nëntor 2018.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 11:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*